

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT - OPSTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	10-03/2025-0016928/25
Nr. i faqeve Br. stranic No. pages	4
Data Datum Date	15.10.2025



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of North Mitrovica



KOMITETI PËR KOMUNITETE

KOMITET ZA ZAJEDNICE

COMMUNITIES COMMITTEE

Kuvendi Komunal

Me datën: 15.09.2025

PROCESVERBAL

NGA TAKIMI I 39-të i

KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Takimi i 39-të i Komitetit për Komunitete u mbajt më datë 15.09.2025 në hapësirat e Komunës së Mitrovicës së Veriut, me fillim në ora 13:00.

Në takim ishin të pranishëm këta anëtarë të Komitetit për Komunitete:

1. Naxhije Xhema – Kryesuese e Komitetit për Komunitete
2. Skender Sadiku – Zëvendëskryesues i Komitetit për Komunitete
3. Katarina Adjancic – Nënkyetare e Komunës së Mitrovicës së Veriut
4. Nedžad Ugljanin – Kryesues i Kuvendit Komunal
5. Jahir Demaku – Anëtar
6. Lumni Xhaka – Anëtar
7. Perihan Jakupi – Anëtare
8. Igor Rajčić – Anëtar

Munguan:

1. Azemina Ćulum
2. Belma Ajvazi

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit për Komunitete, znj. Naxhije Xhema, e cila në fillim përshëndeti të pranishmit.

Pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
2. Raporti gjashtëmujor i Komitetit për Komunitete
3. Raporti gjashtëmujor i Zëvendëskryesuesit për Komunitete
4. Mos-pagesa e anëtarëve të Komisionit për Komunitete dhe procesmbajtëses
5. Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve
6. Të ndryshme

Kryesuesja: A pajtoheni me këtë rend dite? Kush është për?

Rendi i ditës votohet me: 4 vota për, 0 kundër, 0 abstenime.

Kryesuesja: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës – **Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar.** Procesverbali është dërguar me email. A ka ndonjë vërejtje? Nëse jo, e hedh në votim. Kush është për?

Procesverbali votohet me: 4 vota për, 0 kundër, 0 abstenime.

Kryesuesja: Kalojmë në pikën e dytë – **Raporti gjashtëmujor i Komitetit për Komunitete.** Siç e dini, kjo pikë ishte në rend dite edhe në takimet e kaluara, por për shkak të mungesës së anëtarëve nuk kemi mundur ta mbajmë dhe prezantojmë raportin.

Kryesuesja prezanton raportin gjashtëmujor të Komitetit për Komunitete: Janar - Qershor 2025.

Kryesuesja: Nëse dikush dëshiron të marrë fjalën lidhur me raportin gjashtëmujor?

Nënkryetarja: Dëshiroj t'ju njoftoj lidhur me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ka qenë kërkesë e Komunës. Ministria ka konfirmuar se do të bëhet vetëm renovimi i ambulantës në Kodrën e Minatorëve. Kryetari, Nënkryetarja dhe Drejtoresha e Shëndetësisë kanë kërkuar që të shtohet edhe stomatologjia, mirëpo ministria nuk ka pranuar. Edhe autoambulanca aktuale do të transferohet në ambulantën në Kodrën e Minatorëve. Kjo është e gjitha për këtë vit, pasi nuk ka më buxhet. Kështu na ka informuar Ministria e Shëndetësisë.

Skenderi: Kam qenë atje dhe ishte tmerr. 4 muaj ajo ambulantë ka qenë pa mjek. Është turp për ne. Ndërkohë konkursi është hapur dhe janë pranuar mjekë. Duhet ta trajtojmë si çështje emergjente.

Kryesuesja: Falënderoj Nënkryetaren dhe Kryesuesin që gjithmonë kanë gjetur kohë për ne. A ka diçka për të shtuar apo kalojmë në pikën tjetër?

Igori: Nëse është e mundur, ta përfundojmë më shpejt, sepse kam vetëm edhe 10 minuta kohë dhe nuk dua të prishet kuorumi.

Kryesuesja: Vazhdojmë me pikën tjetër – **Raporti gjashtëmujor i Zëvendëskryesuesit për Komunitete.**

Skenderi: Prezanton raportin gjashtëmuor të Zëvendëskryesuesit për Komunitete: Janar - Qershor 2025.

Kryesuesja: Keni diçka për të shtuar lidhur me raportin?

Kryesuesja: Kalojmë në pikën tjetër – **Mos-pagesa e anëtarëve të Komisionit për Komunitete dhe procesmbajtëses.** Sot e kemi ftuar edhe Kryesuesin e Kuvendit Komunal. Është kënaqësi që është këtu. Urdhëroni, ju lutem.

Nedžad: Përshëndetje të gjithëve. Sot kam pasur takim me avokatët Enver Qerkini dhe Agim Lushta. Ata kanë marrë përsipër këtë çështje. Siç e dini, vendimi është marrë, por si Kryesuese e Komisionit je e obliguar të evidentosh për sa muaj nuk janë paguar anëtarët, pasi disa nuk kanë qenë të pranishëm çdo muaj. Fillimisht do të shkojë një njoftim në komunë, pastaj do të ndiqet përmes përmbaruesit. Tani në fund të muajit kemi buxhetin për ta miratuar, por nuk do të votohet pa u paguar anëtarët. Ju e dini çfarë ndodh nëse nuk miratohet buxheti – edhe punonjësit e administratës mbesin pa rroga. Ne jemi të obliguar t'i mbrojmë anëtarët e këtij komisioni. Deri më 18 shtator duhet të jetë gjithçka e përgatitur, sepse përmes nesh si kryesues shkon njoftimi te Kryetari. Pas një jave apo 15 ditësh – nuk e di saktë afatin – nisët procedura. Edhe në mbledhjen e kaluar e kam cekur mos-pagesën, kur ishte i pranishëm Kryetari. Ai pyeti Drejtoreshën nëse ka fonde në shërbime dhe mallra. Ne nuk kemi pse na intereson ku i gjen fondet. Komunitet tjerë i kanë kryer pagesat. Obiliqi ishte i fundit që përfundoi pagesat, për shkak të ndryshimeve ligjore për shërbimin civil. KPF-ja ka mbetur në kuadër të Kuvendit sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Ky ligj e obligon Komunitetin të funksionalizojë KPF-në dhe Komisionin për Komunitete. Nuk ka ndonjë kompensim për shërbimet e avokatëve, dhe çdo anëtar duhet të nënshkruhet. Avokati Enver Qerkini, përfaqësues i Komunitetit të Skenderajt, është i njohur me këtë proces. Edhe atje kanë pasur të njëjtin problem dhe është zgjidhur brenda 3 muajve.

Igori: Ju keni qenë në pozitë të bllokoni punët e ekzekutivit shumë më herët, jo tani në fund të mandatit. Mos e shfrytëzoni çështjen e mos-pagesës sonë për të bllokuar buxhetin, sepse nëse kur të vijë legjislatura e re, ne si anëtarë mbajmë përgjegjësi indirekt.

Skenderi: Të lutem, Kryesuese, largoje nga fjalori fjalën "ne", dhe fol vetëm në emrin tënd. Kam një pyetje: a i keni shfrytëzuar të gjitha resurset brenda komunës? Komuna ka juristë dhe përmbarues. Pse duhet që Enver Qerkini dhe Agim Lushta ta marrin përsipër këtë çështje, kur ne kemi juristë brenda dhe mundësi juridike? Derisa kjo çështje nuk është e përfunduar këtu, nuk është hapur debat as këtu, e as në Asamblenë Komunitetale.

Kryesuesja: Në Kuvend ka ardhur vendimi dhe marrëveshja për t'u paguar këta persona, dhe për një nënshkrim të munguar nuk janë duke u paguar ata.

Skenderi: Të lutem, Kryesues, jemi në kohë fushate dhe raportet tashmë janë ndryshe. Rrugët janë ndarë dhe jemi në fushatë. Ki kujdes, mos fol në shumës, por vetëm në emrin tënd.

(Skenderi dhe Kryesuesi diskutojnë rreth çështjes së mos-pagesës së anëtarëve dhe procesmbajtësës.)

Lumni: Vendimin e kemi marrë, por Kryetari nuk ka ndërmarrë asgjë. Çfarë kemi ne më shumë për të bërë?

Nedžad: Në fakt, ne jemi duke përgatitur padi ndaj Komunës.

Kryesuesja: Kalojmë në pikën tjetër – **Kërkesat e qytetarëve.** Siç e dini, çdo herë këtu i shtjellojmë kërkesat e qytetarëve, mirëpo kësaj here nuk kam pranuar asnjë kërkesë.

Skenderi: Kemi një email me kërkesë nga banorët e lagjes së Doktorëve. Bëhet fjalë për kërkesë për energji elektrike. Kjo kërkesë na është adresuar përmes emailit.


Kryesuesja: Në emailin tim nuk ka ardhur asnjë kërkesë, përveç nëse ka ardhur ndërkohë.

Nedžad: Nesër kemi KPF-në dhe kemi mbajtur debat me qytetarët. Më ka ardhur një kërkesë që është drejtuar Kuvendit, Ministrisë dhe të gjithëve. Kemi pasur debat për energjinë elektrike dhe do ta hap edhe atë kërkesë që është adresuar.

Kryesuesja: Kalojmë në pikën tjetër – **Të ndryshme.** Nëse nuk keni ndonjë çështje tjetër, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje.


Takimi përfundon në orën 14:00.

Procesmbajtës:
Bujar ISUFI



Kryesuese e Komitetit për Komunitete:
Naxhije XHEMA





Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of North Mitrovica

KOMITETI PËR KOMUNITETE

KOMITET ZA ZAJEDNICE

COMMUNITIES COMMITTEE

Skupština Opštine

Datum: 15.09.2025. god.

Z A P I S N I K

SA 39-og SASTANKA

ODBORA ZA ZAJEDNICE

Trideset deveti (39) sastanak Odbora za Zajednice je održan dana 15.09.2025. godine u prostorijama Opštine Severna Mitrovica, sa početkom u 13:00 časova.

Sastanku Odbora za zajednice su prisustvovali:

1. Naxhije Xhema – Predsedavajuća Odbora za Zajednice
2. Skender Sadiku – Zamenik Predsedavajućeg za Zajednice
3. Katarina Adjančić – Zamenica Gradonačelnika Opštine Severna Mitrovica
4. Nedžad Ugljanin – Predsedavajući Skupštine Opštine
5. Jahir Demaku – Član
6. Lumni Xhaka – Član
7. Perihan Jakupi – Član
8. Igor Rajčić – Član

Članovi koji nisu bili prisutni:

1. Azemina Ćulum
2. Belma Ajvazi

Sastankom predsedava Predsedavajuća Odbora za Zajednice gđa Naxhije Xhema koja je na početku sastanka pozdravila prisutne.

Dnevni red:

1. Usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka
2. Šestomesečni izveštaj o radu Odbora za Zajednice
3. Šestomesečni izveštaj Zamenika Predsedavajućeg za Zajednice
4. Neisplaćanje članova Odbora za Zajednice i zapisničara
5. Razmatranje zahteva građana
6. Razno

Predsedavajuća: Da li se slažete sa ovim dnevnim redom? Dajem dnevni red na glasanje, ko glasa za?

Dnevni red je usvojen sa: 4 glasa za, 0 protiv, 0 uzdržanih.

Predsedavajuća: Prelazimo na prvu tačku dnevnog reda – **Usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka.** Zapisnik je poslat mejlom. Ima li primedbe? Ukoliko nema, dajem zapisnik na glasanje. Ko glasa za?

Zapisnik je usvojen sa: 4 glasa za, 0 protiv, 0 uzdržanih.

Predsedavajuća: Druga tačka dnevnog reda je – **Šestomesečni izveštaj o radu Odbora za Zajednice.** Kao što znate, ova tačka je bila na dnevnom redu i na prethodnim sastancima, ali zbog nedostatka članova nismo mogli da održimo sastanak i predstavimo izveštaj.

Predsedavajuća predstavlja šestomesečni izveštaj o radu Odbora za Zajednice: januar - jun 2025. godine.

Kryesuesja: Da li se neko javlja za reč povodom šestomesečnog izveštaja?

Zamenica Gradonačelnika: Želela bih da vas obavestim o odluci Ministarstva zdravlja, koji je bio zahtev Opštine. Ministarstvo je potvrdilo da će se izvršiti samo renoviranje ambulate u Mikronaselje. Gradonačelnik, Zamenica Gradonačelnika i direktorica zdravstva su tražili da se doda i stomatologija, ali Ministarstvo to nije prihvatilo. Trenutna ambulanta će takođe biti prebačena u ambulantu u Mikronaselje. To je sve za ovu godinu, jer više nema budžeta. To nas je obavestilo Ministarstvo zdravlja.

Skender: Bio sam tamo i bilo je užasno. Ta ambulanta je bez lekara već 4 meseca. Sramota je za nas. U međuvremenu, konkurs je raspisan i lekari su primljeni. Moramo to tretirati kao hitan slučaj.

Predsedavajuća: Zahvaljujem Zamenicu Gradonačelnika i Predsedavajućeg što uvek pronalaze vreme za nas. Ima li nešto da se doda ili treba da pređemo na sledeću tačku?

Igor: Ako je moguće, hajde da ovo brzo završimo, jer mi je ostalo samo 10 minuta, a ne želim da narušim kvorum.

Predsedavajuća: Nastavljamo sa sledećom tačkom – **Šestomesečni Izveštaj Zamenika Predsedavajućeg za zajednice.**

Skender: Predstavlja šestomesečni izveštaj Zamenika Predsedavajućeg za Zajednice: januar - jun 2025.

Predsedavajuća: Imate li nešto da dodate u vezi sa izveštajem?

Predsedavajuća: Prelazimo na sledeću tačku – **Neisplaćanje članova Odbora za Zajednice i zapisničara.** Danas smo pozvali i Predsedavajućeg Skupštine Opštine. Zadovoljstvo nam je što je ovde. Izvolite molim vas.

Nedžad: Poštovanje svima. Danas sam imao sastanak sa advokatima Enverom Ćerkinijem i Agim Ljuštom. Oni su preuzeli ovo pitanje. Kao što znate, odluka je doneta, ali kao Predsedavajuća Odbora ste u obavezi da evidentirate koliko meseci članovi nisu primili plate, pošto neki nisu bili prisutni svakog meseca. U početku će obaveštenje ići opštini, a zatim će se postupati preko sudskog izvršitelja. Sada na kraju meseca imamo budžet koji treba da usvojimo, ali se o njemu neće glasati bez isplate članova. Znači šta se dešava ako budžet nije usvojen – čak i zaposleni u administraciji ostaju bez plata. Mi smo u obavezi da zaštitimo članove ovog odbora. Sve mora biti pripremljeno do 18. septembra, jer preko mene kao Predsedavajućeg obaveštenje ide Gradonačelniku. Posle nedelju dana ili 15 dana – ne znam tačan rok – počinje postupak. Takođe sam pomenuo neisplatu na poslednjem sastanku, kada je Gradonačelnik bio prisutan. Pitao je direktoricu da li ima sredstava u kategoriji robe i usluge. Ne moramo da brinemo odakle dolaze sredstva. Druge opštine su izvršile isplate. Opština Obilić je poslednja završila isplate, zbog zakonskih izmena u vezi sa Civilnom službom. OPF je ostao u okviru Skupštine u skladu sa Zakonom o Lokalnoj Samoupravi. Ovaj zakon obavezuje opštinu da učini OPF i Odbora za Zajednice funkcionalnim. Ne postoji naknada za usluge advokata, a svaki član mora da potpiše. Advokat Enver Ćerkini, je pravni predstavnik Opštine Srbica/ Skenderaj, upoznat je sa ovim procesom. I oni su tamo imali isti problem i on je rešen u roku od 3 meseca.

Igor: Bili ste u poziciji da blokirate rad izvršne vlasti mnogo ranije, a ne sada na kraju mandata. Nemojte koristiti pitanje našeg neplaćanja da blokirate budžet, jer ćemo sutra kada dođe novi saziv zakonodavne vlasti, mi kao članovi snositi indirektnu odgovornost.

Skender: Molim vas, Predsedavajući, da iz svog rečnika izbacite reč „mi“ i da govorite samo u svoje ime. Imam pitanje: da li ste iskoristili sve resurse unutar opštine? Opština ima advokate i sudske izvršitelje. Zašto bi Enver Ćerkini i Agim Ljušta preuzeli ovo pitanje, kada imamo advokate i pravne mogućnosti? Dok se ovo pitanje ovde ne reši, nije otvorena nikakva rasprava ni ovde ni u Skupštini Opštine.

Predsedavajuća: Skupština je donela odluku i sporazum da se ovi ljudi isplate, a zbog nedostajućeg potpisa, oni se ne isplaćuju.

Skender: Molim vas, Predsedavajući, u vreme predizborne kampanje i odnosi su sada već drugačiji. Putevi su se razdvojili i mi smo u režimu kampanje. Pazite, nemojte govoriti u množini, već samo u svoje ime.

(Skender i Predsedavajući raspravljaju o pitanju neisplaćanja članova i zapisničara.)

Lumni: Doneli smo odluku, ali Gradonačelnik nije preduzeo ništa. Šta još možemo da uradimo?

Nedzad: U stvari, pripremamo tužbu protiv Opštine.

Predsedavajuća: Prelazimo na sledeću tačku - **Zahtevi građana**. Kao što znate, svaki put ovde raspravljamo o zahtevima građana, ali ovog puta nisam dobila nijedan zahtev.

Skender: Dobili smo mejl sa zahtevom stanovnika Doktorske Doline. Radi se o zahtevu za struju. Ovaj zahtev nam je upućen putem mejla.


Predsedavajuća: Nijedan zahtev nije stiglo na moj mejl, osim ako je stiglo u međuvremenu.

Nedzad: Sutra imamo sastanak OPF i održali smo raspravu sa građanima. Dobio sam zahtev koji je upućen Skupštini, Ministarstvu i svima. Imali smo raspravu o električnoj energiji i pročitacu i taj zahtev koji nam je upućen.

Predsedavajuća: Prelazimo na sledeću tačku dnevnog reda – **Razno**. Ako nemate drugih pitanja, hvala svima na učešću.

Sastanak je završen u 14:00 časova.

Zapisničar:
Bujar ISUFI



Predsedavajuća Odbora za Zajednice:
Naxhije XHEMA

